REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK BERAT**

# V E N D I M

**NR 83 Datë 28/ 12/ 2021**

## MIRATIMIN E SISTEMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E BERATIT

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", dhe pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja "b", nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja "f", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative–territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.24 datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr.9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare" të ndryshuar, ligjit nr.107/2014 "Për Planifikimin e Territorit" të ndryshuar, VKM nr.132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", ligjn nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", ligjin nr.9385 datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" të ndryshuar, ligjit nr.8450 datë 18.03.1999 "Për procedurat dhe kushtet e dhënies së lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre" të ndryshuar, ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për Fondin kullosor" të ndryshuar, ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" të ndryshuar, ligjit nr. 9220 datë 15.04.2004 "Për shërbimin publik të varrimit" të ndryshuar, udhëzimit nr. 32, datë 31.12.2013 të Ministrit të Financave "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

**V E N D O S I :**

1.Miratimin e taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Berat, sipas materialit bashkëlidhur këtij projektvendimi.

2.Shfuqizimin e Vendimit te Këshillit Bashkiak Berat nr. 60, datë 18.12.2019 të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Beratit", të ndryshuar.

3.Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen drejtoritë, njësitë vartëse dhe njësitë administrative të Bashkisë Berat .

**KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË**

**ERVIN CEÇA**

Vendimi u miratua me 24

__vota kundër

__vota abstenim

**PJESA I**

**PJESA E PËRGJITHSHME**

**TITULLI I**
**TAKSAT VENDORE QË APLIKOHEN NË TERRITORIN E BASHKISË BERAT**

**KREU I**
**TË PËRGJITHSHME**

Neni 1
**Qëllimi**

Ky vendim përcakton llojet e taksave dhe tarifave vendore që zbatohen në territorin e Bashkisë Berat, nivelin e taksave dhe tarifave, procedurat e llogaritjes, baza tatimore, kategorizimet dhe nën kategorizimet, lehtësimit apo përjashtimit, arkëtimit dhe transferimit në buxhetin e bashkisë, si dhe detyrimet që kanë agjentët për mbledhjen e taksave dhe tarifave.

Neni 2
**Llojet e taksave**

1. Në Bashkinë Berat aplikohen këto taksa vendore:
a. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin;
b. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
c. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
d. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;
e. Taksa e fjetjes në hotel;
f. Taksa e tabelës;
2. Përjashtohen nga taksat vendore të gjitha subjektet e parashikuara shprehimisht në këtë vendim apo në akte ligjore dhe nënligjore të veçanta.

Neni 3
**Përkufizime**

Për qëllime të zbatimit të taksës së ndërtesës në Bashkinë Berat, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
1. "Agjent i mbledhjes së taksave dhe tarifave" është personi i cili, sipas kërkesave të këtij vendimi, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogarinë e Bashkisë Berat apo strukturave të saj, të të ardhurave nga taksat dhe tarifat.
2. "Pasuri e paluajtshme" janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.
3. "Kadastra fiskale" është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.
4. "Niveli tregues i taksës" janë nivelet e taksave të parashikuara sipas këtij vendimi.
5. "Çmim vlerësues", njësia matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar.
6. "Ndërtesë", objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në vendim.
7. "Ndërtesë e papërfunduar", objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
8. Njësi pronësore", ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë". Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.
9. "Ndarje e njësisë pronësore për banim", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim

banimi.
10. "Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.
11. "Përdorues", individi, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.
12. "Taksë" është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e Bashkisë Berat që paguhet nga çdo person apo nëpërmjet një agjenti që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Bashkisë Berat.
13. "Tarifë" është pagesa, që një individ, person fizik apo juridik, bën drejtpërdrejt apo nëpërmjet një agjenti tek administrata e Bashkisë Berat. Pagesa bëhet në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë.
14. "Taksapagues", çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, i cili është i detyruar të paguajë njërën nga taksat vendore të përcaktuar në këtë vendim apo legjislacionin në fuqi.
15. "Vlerë e pasurisë", është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore.
16. "Veprimtari ekonomike", është çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

## KREU II
## TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Neni 4
**Taksa mbi pasuritë e paluajtshme**

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:
1. Taksa mbi ndërtesat.
2. Taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa mbi truallin.

Neni 5
**Taksa mbi ndërtesën**

1. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
5. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.
Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit.

Neni 6

**Çmimi mesatar referues për përllogaritjen e taksës**

1. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një

pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të

përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim,

tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.

2. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

3. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e

çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

4. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim,

përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe

objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të

zonës përkatëse sipas qyteteve.

5. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari

mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është

30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të

përpunimit ushqimor.

6. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative

jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të

ligjit nr. 115/2014, reduktohet deri në 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës

më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

Neni 7

**Shkalla e taksës mbi ndërtesat**

1. Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është:
a. 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
b. 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
c. 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
3. Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës, të përcaktuar në aktin e lejes së ndërtimit apo aktin e regjistrimit pranë regjistrave të pasurive të paluajtshme:
a. Apartamente banimi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim".
b. Njësi biznesi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike".
c. Bodrum/parking i mbuluar do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "ndërtesa që përdoret për parkim të mbuluar dhe bodrume".
4. Kur nga verifikimi në terren rezulton se ndërtesa apo njësi të veçanta të saj janë vënë në përdorim/shfrytëzim, pavarësisht se ndërtesa në tërësi nuk ka përfunduar, taksa llogaritet e plotë për pjesën në përdorim/shfrytëzim. Në këtë rast, baza e taksueshme llogaritet me kostot e ndërtimit për pjesën e papërfunduar dhe me çmimet vlerësuese për pjesët e vëna në përdorim. Për pjesë të ndërtesës të vëna në përdorim, baza e taksës do të jetë e plotë. E njëjta situatë vlen edhe kur nuk është dhënë leja e shfrytëzimit të ndërtesës apo nuk është bërë regjistrimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.
5. Sipërfaqja e prezumuar.

Për ndërtesat që përdoren, shfrytëzohet për banim, identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

a. 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;

b. 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuar me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.

6. Për sa i përket kategorisë, ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave dhe/ose agjenti tatimor i caktuar nga Bashkia Berat bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës.

Neni 8

**Lehtësira dhe përjashtimet nga taksa e ndërtesës**

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

1.pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;

2. pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;

3.ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;

4.banesat sociale në pronësi të bashkive;

5.pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;

6. ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;

7.strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";

8.ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;

9.ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

10.ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

11.ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që i përkasin kategorive me status invalid të punës, invalid të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë" si dhe familjet me një pjestarë.

Neni 9

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së ndërtesës**

1. Struktura e Bashkisë Berat e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave.
2. Agjent Tatimor i ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për qëllime banimi në Bashkinë e Beratit është shoqëria Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë" sh.a
3. Në rolin e agjentit tatimor, shoqëria Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë", përfiton një komision prej 2.5 % të shumës së arkëtuar.
4.Për familjet që nuk kanë kontratë me Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë" sh.a pagesa do të kryhet pranë zytave të Drejtorisë së Taskave dhe Tarifave si dhe në Njësitë Administrative përkatëse.

Neni 10

**Verifikimi i subjekteve që përjashtohen nga taksa e ndërtesës**

1. Strukturat e ngarkuara për verifikimin e subjekteve që përjashtohen nga pagesa e taksës për kategorinë e subjekteve familjarë janë Njësitë Administrative dhe Lagjet e Bashkisë Berat.
2. Listat me subjektet e përjashtuara, pasi hartohen nga njësitë administrative dhe lagjet, i njoftohen çdo muaj Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave.

Neni 11

**Dokumentacioni që dorëzohet për të përfituar përjashtimi nga taksa e ndërtesës**

1. Subjektet familjarë që përjashtohen sipas nenit 8, të këtij vendimi, depozitojnë pranë Njësisë Administrative/Lagjes ku kanë vendbanimin, dokumentacionin përkatës që vërteton se:
a. marrin pension pleqërie/pension social;
b. janë kryefamiljarë që kanë në përbërje të familjes vetëm pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre të paaftë për punë;
c. trajtohen me ndihmë ekonomike;
d. janë kryefamiljarë që i përkasin kategorive me status invalid të punës, invalid të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit

politikë" si dhe familjet me një pjestarë
e. kopje të dokumentit ku banojnë që provon se janë pronarë apo përdorues të pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës etj;
f. kopje të kontratës/ librezës/ faturës së abonentit kryefamiljar që bën kërkesën për përjashtim.

Neni 12
**Mënyra e pagesës**

1. Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.
2. Për kategorinë e ndërtesave që shfrytëzohen për banim, detyrimi paguhet në 12 këste të barabarta, për çdo muaj përkatësisht nga çdo familje. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit.
3. Për kategoritë e ndërtesave që përdoren për veprimtari ekonomike, detyrimi paguhet me 2 këste:
a. Kësti i parë, brenda datës 20 Prill
b. Kësti i dytë, brenda datës 20 Korrik.
4. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.
5. Taksa e ndërtesës paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin
6. Nëse subjekti taksapagues hap aktivitet, aplikon për pezullim ose ç'regjistrim pranë QKB-së gjatë vitit fiskal, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar nivelin e taksës për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për regjistrim, pezullim ose ç'regjistrim) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

## KREU III
## TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Neni 13
**Baza dhe llogaritja e detyrimit**

1. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.
2. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar.
3. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.
4. Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, njihen dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në rast mungese të dokumentacionit ligjor verifikimi bëhet nga komisioni i verifikimit të pasurive të paluajtshme i ngritur për këtë qëllim.
5.Pagesa e taksës së tokës bujqësore paguhet pranë Lagjjeve/Njësive administrative ku qyetarët kanë pronën.

Neni 14
**Komisioni i verifikimit**

Kryetari i Bashkisë ngre komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme për tokën bujqësore. Komisioni verifikon vërtetësinë e vetëdeklarimit të sipërfaqes së tokës bujqësore të dorëzuar nga subjekti taksapagues.

Neni 15
**Niveli i taksës**

1. Niveli i taksës mbi tokën bujqësore sipas kategorive është sipas tabelës.

| **Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore** | **Vlera e taksës në lekë/hektar/vit** |
|---|---|
| III | 2,800 |
| IV | 2,300 |
| V | 1,900 |
| VI | 1,600 |
| VII-X | 1,400 |

Neni 16
**Lehtësira dhe përjashtime**

2. Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.
3. Taksapaguesit që i përkasin kategorive me status invalid të punës, invalid të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë" si dhe familjet me një pjestarë

Neni 17
**Struktura për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore**

1. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Berat, në bashkëpunim me Njësinë Administrative/Lagjen përkatëse.
2. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Beratit dhe bashkëpunimi me Njësitë Administrative dhe lagjet rregullohet me rregullore të veçantë të miratuar nga kryetari i Bashkisë Berat.

**KREU IV**
**TAKSA MBI TRUALLIN**

Neni 18

**Baza dhe niveli i taksës mbi truallin**

1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metra katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.
2. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror në vit. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, janë si më poshtë:

| **Niveli i taksës së truallit në lekë për metër katror në vit** | **Lekë/m²/vit** |
|---|---|
| Vlera e taksës së truallit për qëllime banimi nga individët | 0.42 |
| Vlera e taksës së truallit për qëllime biznesi | 18 |

3. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.

Neni 19

**Mënyra e pagesës**

1. Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor.
2. Për kategorinë e truallit që shfrytëzohen për banim, detyrimi paguhet pranë Lagjeve/Njësive Administrative
3. Për kategoritë e ndërtesave që përdoren për veprimtari ekonomike, detyrimi paguhet me 2 këste:
a. Kësti i parë, brenda datës 20 Prill
b. Kësti i dytë, brenda datës 20 Korrik.
4. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.
5. Taksa e ndërtesës paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin
6. Nëse subjekti taksapagues hap aktivitet, aplikon për pezullim ose ç'regjistrim pranë QKB-së gjatë vitit fiskal, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar nivelin e taksës për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për regjistrim, pezullim ose ç'regjistrim) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Neni 20

**Struktura për vjeljen e taksës mbi truallin**

1. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë së Berat në bashkëpunim me Njësinë Administrative/Lagjen përkatëse.
2. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë e Berat dhe bashkëpunimi me Njësitë

Administrative /Lagjen rregullohet me rregullore të veçantë të miratuar nga kryetari i Bashkisë Berat.

## KREU V
## TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Neni 21

**Baza, niveli dhe llogaritja e detyrimit**

1. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.
2. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
3. Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
4. Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre.
5. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
6. Niveli i taksës sipas kategorive, është sipas tabelës më poshtë.

| **KATEGORITË** | **Berat** | **Njësia administrative** | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | **Roshnik** | **Sinjë** | **Otllak** | **Velabisht** |
| | Lek/m$^2$ | | | | |
| I. Ndërtesa banimi | 300 | 100 | 100 | 100 | 100 |
| II.Ndërtesa për tregti dhe shëbime përfshi dhe zyra | 700 | 300 | 300 | 300 | 300 |
| III.Ndërtesa të tjera | 500 | 200 | 200 | 200 | 200 |

Neni 22

**Përjashtimet nga taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë**

1. Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:
a. Enti Kombëtar i Banesave, ministria përgjegjëse për financat dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore.

b. Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar;

c. Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

(i) institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;

(ii)bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak apo struktura e deleguar nga ky i fundit për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

2. Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

Neni 23

**Agjenti tatimor**

1. Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
2. Në rolin e agjentit tatimor, Agjencia Shtetërore e Kadastrës përfiton një komision prej 3 % të shumës së arkëtuar.
3. Struktura e ngarkuar për Akt – rakordimin është Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve

## KREU VI
## TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Neni 24

**Baza dhe niveli i taksës**

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.
2. Niveli i taksës:

| KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË | Niveli i taksës |
|---|---|
| I. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi | |
| a. Me destinacion banim | 5 % e çmimit të shitjes për m2 |
| b. Me destinacion garazhd | 5 % e çmimit të shitjes për m2 |
| c. Me destinacion njësi shërbimi (lokale, dyqane etj...) | 6 % e çmimit të shitjes për m2 |
| II. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën I, për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të | |

| | |
|---|---|
| Ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, | |
| a. Ndërtim banimi për përdorim publik(banesa sociale, me kosto të ulët) | 2 % e vlerës së investimit |
| b. Ndërtim banimi për përdorim vetjak, ndërtime në sektorin e turizmit, industrisë, bujqësisë, blektorisë, shërbimit apo për përdorim publik, garazhd për përdorim vetjak. | 3% e vlerës së investimit |
| c. Ndërtime në sektorin e turizmit në parkun kombëtar të Tomorit | 2 % e vlerës së investimit |
| d. Ndertime çatie në objekte banimi | 1.5 % e vlerës së investimit |
| e. Për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore | 2 % e vlerës së investimit |
| III. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte. | 0,1% e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit |
| IV. Për ndërtesat që janë në proces legalizimi | 0.5% e vlerës së investimit |

Neni 25

**Mënyra dhe afati i pagesës së taksës**

1. Taksa paguhet dhe ngarkohet në sistemin elektronik të lejeve brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së vendimit për miratimin e lejes së ndërtimit dhe lëshimit të autorizimit të pagesës nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve. Nëse në përfundim të këtij afati kërkuesi nuk ka paguar dhe ngarkuar aktet që provojnë pagimin e taksës, autoriteti përgjegjës i dërgon kërkuesit, nëpërmjet sistemit elektronik, vendimin për refuzimin e lejes së ndërtimit".
2. Taksa paguhet nga individi/subjekti i interesuar në çdo moment dhe gjithsesi jo më vonë se 45 ditë nga data e dhënies së lejes së legalizimit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Nëse subjekti/personi i interesuar nuk kryen pagesën brenda këtij afati, atëherë për çdo ditë vonesë i llogaritet kamatë 0,1 për qind në ditë e shumës që duhet të paguajë, deri në 30 ditë pune.
3. Për kategoritë ku niveli i taksës aplikohet mbi vlerën e investimit, në përfundim të punimeve të kryera sipas lejes së miratuar, bëhet kontrolli i pagesave me situacionin përfundimtar të objektit të ndërtuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve dhe nëse ka diferenca mes vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar dhe preventivit, njoftohet subjekti për vlerën e diferencës që është i detyruar të shlyejë. Mosshlyerja e këtij detyrimi përbën shkak për pezullimin e procedurave të pajisjes me leje përdorimi të subjektit.

Neni 26

**Struktura për përllogaritjen dhe vjeljen e taksës**

1. Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve.
2. Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat në proces legalizimi është Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve.

Neni 27

**Përjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja**

1. Përjashtohen nga detyrimi i pagesës së kësaj takse:
a. investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht *"brand name"*.
b. investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
c. investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
ç. investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

**KREU VII**
**TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL**

Neni 28

**Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël**

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8,000,000 (tetë milionë) lekë, u nënshtrohet detyrimeve të parashikuara në këtë kre.
Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.
Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero).

Neni 29

**Baza dhe niveli i detyrimit**

1.Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave

Neni 30
**Mënyra e pagesës**

1.Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e administratës tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës:
a. 20 prill të çdo viti, për muajt janar, shkurt e mars;
b. 20 korrik të çdo viti, për muajt prill, maj e qershor;
c. 20 tetor, për muajt korrik, gusht e shtator;
d. 20 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor.

2.Në rast se aktiviteti i biznesit hapet, mbyllet apo pezullohet gjatë vitit fiskal, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël është proporcional me kohën e zhvillimit të aktivitetit dhe llogaritet në bazë të vetëdeklarimit të tatimpaguesit. Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë gjatë vitit, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin llogaritet në bazë të qarkullimit dhe të fitimit të tatueshëm, të parashikuar nga vetë tatimpaguesi, për periudhën nga data e regjistrimit deri në fund të vitit të parë kalendarik.

3.Pagesat e kësteve të tatimit kryhen te bankat e nivelit të dytë dhe Postës Shqiptare për llogari të administratës tatimore, brenda datave 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor të çdo viti. Me kryerjen e pagesës dhe marrjen e konfirmimit bankar të kryerjes së pagesës, tatimpaguesi shkon te zyrat e shërbimit tatimpagues tatimor dhe, kundrejt paraqitjes së dokumentit bankar të pagesës, merr "Pullën e tatimit" të kështit, për të cilin ka bërë pagesën. Dizenjot dhe elementet e pullës caktohen me udhëzim të Ministrit të Financave

Neni 31
**Struktura për vjeljen e taksës**

1.Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet. Administrata Tatimore Qendrore, për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në
llogari të Administratës Tatimore Qendrore. Komisioni kalon në llogari të Buxhetit të Shtetit, në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përdorimin e të ardhurave dytësore, të krijuara në institucionet buxhetore dhe për mbulimin e kostove të "Pullave të tatimit"
3. Struktura përgjegjëse për kryerjen e akt akordimeve me Drejtorinë Rajonale Tatimore është Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

## KREU VIII
## TAKSA E FJETJES NE HOTEL

Neni 32
**Baza dhe niveli i detyrimit**

1. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara ne hotel. Janë subjekt i taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.
2. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel
3. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.
4. Niveli i taksës

| **Kategoritë e njësive akomoduese hotelerike** | **Berat** | **Dhe të gjitha njësitë administrative jashtë qytetit, të cilat ju bashkuan njësive të vetëqëverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr.115/2014** |
|---|---|---|
| Hotel me 4 dhe 5 yje | 175 | 105 |
| Hotel nën 4 yje, motel, hostel, bujtinë si dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin | 70 | 35 |

Neni 33
**Struktura për vjeljen e taksës**

1. Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës se fjetjes ne hotel është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Berat.
2. Të ardhurat kalojnë 100% për Bashkinë Berat.
3. Mënyra e deklarimit dhe raportimit për operatorët ekonomikë që janë subjekt i taksës së fjetjes në hotel, kryhet nëpërmjet vetëdeklarimit
4. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës

## KREU IX
## TAKSA E TABELËS

Neni 34

**Fusha e zbatimit dhe kategorizimet**

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.
2. Për qëllime të zbatimit të këtij vendimi, tabelat kategorizohen në:
a) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabele identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.
b) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.
c) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.
ç) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.
3. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
4. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë e shkruar, e stampuar apo e pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën.
Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve apo shërbimeve që furnizohen nga vetë njësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabele. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.
Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabele identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në

njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabele.

Neni 35

**Niveli i taksës**

Nivelet e taksës së tabelës, sipas kategorizimeve të përcaktuara në nenin 33 është si më poshtë:

| Nr | Pershkrimi | Njesia | Vlera |
|---|---|---|---|
| a. | Deri në 2m$^2$ | Leke/ m$^2$ /vit | 0 |
| b. | Mbi 2 m$^2$ deri në 10 m$^2$ | | |
| | E thjeshtë pa ndricim | Leke/ m$^2$ /vit | 10 000 |
| | Me ndricim të thjeshtë | Leke/ m$^2$ /vit | 15 000 |
| | Elektronike | Leke/ m$^2$ /vit | 20 000 |
| c. | Mbi 10 m$^2$ deri në 20 m$^2$ | | |
| | E thjeshtë pa ndricim | Leke/ m$^2$ /vit | 8500 |
| | Me ndricim të thjeshtë | Leke/ m$^2$ /vit | 12 750 |
| | Elektronike | Leke/ m$^2$ /vit | 17 000 |
| ç. | Mbi 20 m$^2$ deri në 40 m$^2$ | | |
| | E thjeshtë pa ndricim | Leke/ m$^2$ /vit | 5500 |
| | Me ndricim të thjeshtë | Leke/ m$^2$ /vit | 8250 |
| | Elektronike | Leke/ m$^2$ /vit | 11 000 |
| d. | Mbi 40 m$^2$ | | |
| | E thjeshtë pa ndricim | Leke/ m$^2$ /vit | 4000 |
| | Me ndricim të thjeshtë | Leke/ m$^2$ /vit | 6000 |
| | Elektronike | Leke/ m$^2$ /vit | 8000 |
| II | Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formë dhe përmasa e tabelave për orientim. | | |
| | Tabela identifikuese | Leke/ m$^2$ /vit | 120 |
| III | Tabela për qëllime reklamimi e lëvizshme e pa lëvizshme deri në tavanin ,aksimal 35 m$^2$ | | |
| | E thjeshtë( me/ pa ndricim) | Leke/ m$^2$ /vit | 22 500 |
| | Elektronike | Leke/ m$^2$ /vit | 45 000 |
| IV | Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura , spektakle stenda reklamuese, banderola etj. | | |
| | Të të gjitha llojeve dhe përmasave | 1000 Leke/ m$^2$ /ditë | |

***Shënim:***

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m2 , shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqe deri në 10 m2 do ti shtohet, shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10 m2 të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës.

Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy

tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë.

Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35 m2 , do të konsiderohet sikur është 35 m2 dhe shuma

e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarsishtë madhësisë së saj në m2 .

Neni 36

**Procedura për paisjes me leje**

Për kategorinë I "Tabelë për qëllime identifikimi" dhe kategorinë II "Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit"dhe III "Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e pa lëvizhshme ", IV Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj. Çdo subjekt duhet të plotësoj këtë dokumentacion:

1.Paraqitja e kërkesës me shkrim pranë Bashkisë Berat
2.Paraqitja e plan vendosjes
3.Marrja e miratimit nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve.
4.Pagesa e lejes për vendosjen e tabelës
5.Lidhja e Akt marrëveshjes dhe pagesa e taksës për qëllime reklamimi
6.Ndjekja e preocedurave perkatese sipas percaktimeve mesiper.

Neni 37

**Mënyra e pagesës**

Taksa e tabelës paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin si dhe për çdo tabelë të vendosur.

Detyrimi për taksën e tabelës paguhet me dy këste:

- Kësti i parë, brenda datës 20 Prill.
- Kësti i dytë, brenda datës 20 Korrik

Nëse subjekti i biznesit hap aktivitet tregtar pas datës 20 Prill, detyrimi tatimor paguhet brënda 30 ditëve nga data e regjistrimit.

Nëse subjekti taksapagues hap aktivitet, pezullon veprimtarinë ose aplikon për ç'regjistrim pranë QKB-së gjatë vitit fiskal, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar nivelin e taksës për

vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për regjistrim, pezullim ose ç'regjistrim) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Neni 38

**Struktura për vjeljen e taksës**

1.Struktura për përllogaritjen dhe mbledhjen e taksës së tabelës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave.

2.Struktura për dhënien e lejeve për reklamat ose tabelat është Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve.

## TITULLI II

## TARIFAT VENDORE

Neni 39

**Llojet e tarifave**

1. Bashkia Berat aplikon tarifat vendore si më poshtë:
a. Tarifa e pastrimit e largimit të mbeturinave dhe mirëmbatjes së hapësirave publike;
b. Tarifa e ndriçimit publik;
c. Tarifa e gjelbërimit publik
d. Tarifa për infrastrukturën arsimore
e. Tarifa e parkimit të automjeteve
f. Tarifa për zënien e hapësirave publike;
g. Tarifat e tregut
gj. Tarifa për dhënie licence për tregtim karburanti e lëndë djegëse;
i. Tarifa në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
j. Tarifa e tregtimit në tregun industrial;
k. Tarifa për liçensë/certifikatë në fushën e transportit rrugor;
l. Tarifat e shërbimeve që kryen drejtoria e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit (mzsh).
m. Tarifa të shërbimit administrativ të Bashkisë Berat
n. Tarifa e ndikimit në mjedis
o. Tarifa për leje ushtrim aktiviteti për subjektet, aktivitetit i të cilave është burim zhurme
p. Tarifa e shërbimit të varrimit
q. Tarifa të institucioneve të varësisë

## KREU I

Neni 40

**TARIFA E PASTRIMIT E LARGIMIT TË MBETURINAVE DHE MIRËMBATJES SË HAPËSIRAVE PUBLIKE**

1. Tarifës së pastrimit e largimit të mbeturinave dhe mirëmbatjes së hapësirave publike i nënshtrohen të gjithë familjet që kanë gjendjen civile në Bashkinë Berat. Personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Beratit.
2. Niveli i tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave dhe mirembajtjes së hapësirave publike sipas kategorive dhe nënkategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme,

| KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË | Njësia administrative | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Berat | Roshnik | Sinjë | Otllak | Velabisht |
| | Lekë/vit | | | | |
| **I. FAMILIARËT** | | | | | |
| a. Për çdo familje | 1,800 | 1,400 | 1,400 | 1,400 | 1,400 |
| b. Kryefamiljarët që i përkasin kategorive me status invalid të punës, invalid të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë" si dhe familjet me një pjestarë. | 900 | 700 | 700 | 700 | 700 |
| c. Personat që përfitojnë pension pleqërie, kur familja e tyre përbëhet çift pensionistësh. | 1,300 | 1,200 | 1,200 | 1,200 | 1,200 |
| **II. SUBJEKTE TË TATIMIT TË THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL** | | | | | |
| a.Restorant, Ushqim i shpejtë, Piceri | 21,000 | 14,000 | 14,000 | 15,000 | 15,000 |
| b.Prodhim | 21,000 | 14,000 | 14,000 | 15,000 | 15,000 |
| c.Shërbime | 9,000 | 9,000 | 9,000 | 9,000 | 9,000 |
| ç.Transport | 9,000 | 9,000 | 9,000 | 9,000 | 9,000 |
| d.Shitje me pakicë & Ushqimore | 18,000 | 13,000 | 13,000 | 15,000 | 15,000 |
| e.Bar- kafe | 18,000 | 10,000 | 10,000 | 13,000 | 13,000 |
| f.Profesione të lira | | | | | |
| - Noter, farmaci, avokat, përmbarues, stomatolog, labratore mjekesore dhe dentar | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 |
| - Profesione te lire te tjera | 11,000 | 11,000 | 11,000 | 11,000 | 11,000 |
| g.Ambulant | 3,400 | 1,300 | 1,300 | 1,300 | 1,300 |
| **III. SUBJEKTE TË TATIMIT MBI FITIMIN** | | | | | |
| a.Prodhim | 83,000 | 83,000 | 83,000 | 83,000 | 83,000 |
| b.Ndërtim | 110,000 | 110,000 | 110,000 | 110,000 | 110,000 |
| c.Transport | 22,000 | 22,000 | 22,000 | 22,000 | 22,000 |
| ç.Import eksport , sherbime, tregti. | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 50,000 |
| d.Per subjekte që nxjerrin gurin ranor | 100,000 | 100,000 | 100,000 | 100,000 | 100,000 |
| e. Banka dhe institucionet financiare | 70,000 | 70,000 | 70,000 | 70,000 | 70,000 |
| f. OJF | 16,000 | 16,000 | 16,000 | 16,000 | 16,000 |
| **IV. INSTITUCIONE SHTETËRORE** | | | | | |
| a. Për çdo institucion shtetëror me numër të punësuarish ≤ 5 vetë | 27,000 | 27,000 | 27,000 | 27,000 | 27,000 |
| b. Për çdo institucion shtetëror me numër të punësuarish 5 deri 20 vetë | 45,000 | 45,000 | 45,000 | 45,000 | 45,000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| c. Për çdo institucion shtetëror me numër të punësuarish > 20 vetë | 77,000 | 77,000 | 77,000 | 77,000 | 77,000 |

Neni 41

**Mënyra e pagesës së tarifës së pastrimit e largimit të mbeturinave dhe mirëmbatjes së hapësirave publike**

